

Tiranë me, 11/02/2020

FTESË PËR OFERTË

ME OBJEKT: SHERBIM PASTRIMI PER AMBIENTET E PROJEKTIT YEEP

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë sociale, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët, të cilët kanë humbur kujdesin prindëror, apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë në familjet e tyre biologjike.

SOS Fshatrat e Fëmijëve mbështet gjithashtu fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë përmes projekteve, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të këtyre familjeve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare, SOS Kinderdorf International, krijuar nga Herman Gmeiner në vitin 1949. Ajo është prezente në 136 vende në botë në shërbim të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është duke implementuar projektin tre vjeçar " **Perspektiva që mundësojnë punësimin e të rinjve - YEEP** ", themeluar nga Ministria Federale e Gjermanisë për Zhvillim dhe Bashkeveprim Ekonomik dhe Fondacionit Gjerman Hermann Gmeiner.

Qëllimi i kësaj ftese për ofertë është për të krijuar një kontratë me një kompani e cila ofron shërbimin e pastrimit bazuar mbi nevojat tona në kuadër të zhvillimit të projektit "Perspektiva që mundësojnë punësimin e të rinjve - YEEP" i cili zbatohet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri me adrese Sauk, Tiranë.

Për ofrimin e këtij shërbimi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri fton të gjitha kompanitë që kanë licensë për ushtrimin e kësaj veprimtarie, që të paraqesin interesin e tyre para datës 17.02.2020, duke paraqitur ofertat financiare dhe dokumentat plotësuese të mbyllura në zarf.

MËNYRA E PJESËMARRJES NË TENDER

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj dorazi me vulë dhe emërtimin "Ofertë për Shërbim pastrimi" dhe kompania që e dorëzon, pranë zyrave të Shoqatës sonë deri më datë 17/02/2020 ora 15:00 me adresë:

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri
Rruga Qemal Stafa, P 1, Ap 15
Tiranë, Shqipëri; Tel: + 355 44 536 901

Zarfi duhet të protokollohet pranë sekretarisë të Zyrave Qendrore të Shoqatës dhe Kompania duhet të sigurohet që kjo ofertë është protokolluar. Për të shmangur çdo paqartësi, kërkojmë që përfaqesuesi i kompanisë të mos largohet nga Zyrat Qendrore të Shoqatës pa marrë numrin e protokollit të ofertës.

Në rast se oferta juaj dorëzohet e hapur, me e-mail, fax ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ajo e kërkuar më lart, oferta nuk do të konsiderohet e vlefshme.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave në SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, në adresën e mësipërme është datë 17/02/2020 ora 15:00.

Oferta duhet të jetë e vlefshme për minimumi 30 ditë.

Dokumentat duhet të përmbajnë:

Kopje te Ekstraktit Historik, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit jo më parë se një muaj.

Kopje NIPT-i.

Kopje kontrate (dy-tre) për punë të ngjashme ose kopje dokumenti për realizim kontrate me subjekte të tjera.

Ofertën Financiare e cila duhet të përfshijë çmimin e shërbimit përfshirë TVSH për një muaj.

Ju lutem përdorni tabelën e mëposhtëm për propozimin tuaj financiar. Ju mund të shtoni specifikime apo shpjegime nëse e shikoni të arsyeshme:

Pershkrimi: Shërbim pastrimi ditor, pa përfshirë materialet e pastrimit	Çmimi total i shërbimit i cili përfshin edhe TVSH-ne. Çmimi të përfshijë shërbimin për një muaj.
<ul style="list-style-type: none"> • Pastrim ambiente zyrash (3 ambiente), dhomë trainimesh dhe guzhinë, sallë kompjuterash, dhe ambiente të përbashkëta; • Pastrim i tualeteve (3 tualete); • Pastrim korridoresh (3 hapësira) dhe ballkonesh (4 ballkone); • Pastrim dritaresh nga brenda dhe jashtë; • Hedhje mbeturinash, etj; 	

Propozimi juaj, nëse pranohet, do të ndihmojë për hartimin e kontratës ndërmjet kompanisë tuaj dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri e cila do të jetë një vjeçare me të drejtë rinovimi por jo më shumë se 34 muaj.

Shërbimi i pastrimit do të përfshijë punonjesin e pastrimit pa materialet e pastrimit dhe shërbimi i pastrimit duhet të ofrohet gjatë orarit zyrtar të punës 08.00-16.00.

Ju lutemi, nëse dëshironi të shihni ambientet, jeni të lutur të vizitoni në adresën:

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri,
Rruga. "Hermann Gmeiner", Nr. 5
Sauk, Tiranë

Për çdo pyetje ose sqarim mund të na shkruani në e-mail: info@soskd.org.al.

Përgjigjet e pyetjeve do të ndahen me të gjitha kompanitë që marrin pjesë në tender në version elektronik.

Çdo ofertë e marrë pas datës së mbylljes së procedurës nuk do të pranohet.

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit dhe ofertën financiare.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e Furnizuesit dhe paraqitjen e ofertës.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.